# SHENIME PER DEKLARIMET FINANCIARE

## 1. Organizimi, Objekti dhe Kontributet, Pronesia mbi aktivet, Kapitali dhe Administrimi

### Organizimi

Shoqëria "Grifin Albania" sh.p.k është krijuar si shoqëri përgjegjësi të kufizuar dhe regjistruar ne QKB ne date 21.01.2016, me aktivitet kryesor ne fushen e Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim, DDD), shërbime kundër gjarpërinjve, zogjve, etj dhe dëmtues të ndryshëm në fushën e shëndetit publik, veterinarisë, bimëve, mjedisit, etj në ambiente të ndryshme. Shërbime pastrimi, higjenizimi, deodorizimi dhe ekspertizë higjeno-sanitare, me kapital themeltar ne vleren 100,000 leke i cili perfaqësohet nga kontributi i ortakëve Znj.Vinela Refugjati me 1 kuotë me vlerë 50.000 Lek dhe Z. Endri Haxhiraj me 1 kuotë me vlerë 50.000 Lek, me seli ne adresen: Rruga 3 Dëshmorët, Lagjia Yzberisht, Pasuria Nr 368/19-N1, Zona Kadastrale 3866, Tiranë.
Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

### Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "Grifin Albania" sh.p.k ka si objekt : Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim, DDD), shërbime kundër gjarpërinjve, zogjve, etj dhe dëmtues të ndryshëm në fushën e shëndetit publik, veterinarisë, bimëve, mjedisit, etj në ambiente të ndryshme. Shërbime pastrimi, higjenizimi, deodorizimi dhe ekspertizë higjeno-sanitare. Të hapë dhe të menaxhojëe spitale, klinika, farmaci veterinare, pet shop, etj si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë me aktivitetet e mësipërme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Përfaqësues/agjent dhe shpërndarës për shitjen me shumicë e pakicë të produkteve dhe paisjeve të firmave të huaja/vendase, në fushën e kontrollit të dëmtuesve (pest control), veterinarisë, pastrimit, higjenizimit, kondicionimit të ambienteve të ndryshme të banimit, publike dhe industriale si dhe të çdo operacioni tregëtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Konsulencë për programet parakusht për sistemin HACCP, sistemin HACCP, programeve të kontrollit të cilesisë ISO, higjenën ambientale, fushën e veterinarisë, bujqësisë, mjedisit, energjisë së ripërtëritshme, turizmin, etj. Shoqëria për ofrimin e shërbimeve të mësipërme në bazë të normativave në fuqi, mund të shfrytezojë edhe palë të treta, për veprimtari në fusha të veçanta (në të cilat ligji përcakton drejtimin nga specialistë të licensuar) shoqëria do të punësojë me kontrata pune specialist të licensuar sipas fushës përkatëse. Të ofrojë konsulencë dhe shërbime në fushëm e turizmit dhe të hotelerisë.Të hapë dhe të menaxhojë hotele, restorante, bare, etj. Pjesëmarrja në shoqëri të çdo lloji, partneriteti, ente, shoqata dhe subjekte të çfarëdolloj natyre me objektiv të ngjashëm apo analog me atë të shoqërisë. Organizimin e kurseve profesionale/teknike/, seminareve, konferencave, etj në fushën "pest control", shëndetit publik, higjenën ambientale, veterinarisë, bujqësisë, mjedisit, turizmit, etj; organizimin/realizimin e aktiviteteve promovuese në përgjithësi dhe tregëtimin e materialeve të ndryshme si broshura, libra, etj, për qëllimet e mësipërme. Import-export, prodhim/shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve/pajisjeve higjeno-sanitare, biocideve, barnave dhe produkteve veterinare, bujqësore, mbrojtjes së bimëve, fara bimësh/lule, produkte ekologjike, industriale, komerciale dhe artizanale, panele fotovoltaike, panele diellore, kancelari, pjesë këmbimi për aparatura të

SHËRBIM EKOLOGJIK DHE KONSULENCË
GRIFIN ALBANIA SHPK
NIPT. L61321012S
INTEGRATED PEST MANAGEMENT

BeeWise Shpk
L82320048F / +355-67-2339473
Rr. Astrit Losha, P.300/142, K1N15, Unaza e Re, Tiranë
www.beewise.net bee@beewise.net

ndryshme, aparatura të ndryshme elektronike, materiale mirëmbajtje, si dhe çdo operacion tregëtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Tregtim të materialeve të ndryshme, me pakicë dhe shumicë në format e parashikuara dhe të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Hapja dhe menaxhimi i agjensive të pasurisë së paluajtshme/luajtshme të makinave, makinerive, etj.Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaj. Të përfaqësojë shoqëri të huaja. Blerja pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, mjete dhe makineri të ndryshme, ti marrë ose ti lëshojë me qera, si dhe të bëjë ndërtime, rikonstruksione, rregullime, shërbime, etj apo të transferojë tek palët e tjera punët e tyre me pakicë dhe shumicë. Marja pjesë nëpër ankande dhe tendera të ndryshëm. Shitje bicikletash te thjeshta, shitje bicikletash me bateri te kategorive te ndryshme, shitje aksesoresh per bicikleta, sherbim per mirembajtjen dhe riparimin e bicikletave.Shitje e produkteve mbrojtese personale dhe te DDD-ve". "Shitje te sistemeve te filtrimit dhe higjenizimit te ujit". "Sherbime DDD per mjetet tokesore, detare dhe ajrore Kontributi ne shoqeri perfaqesohet nga kapitali i ortakeve Endri Haxhiraj 50% dhe Vinela Refugjati 50%.

### Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne ambient zyre me qera. Aktivet e saj perbehen nga makineri e paisje pune, Mobilje Orendi, Pajisje Kompjuterike, Mjete transporti, etj.

### Kapitali

Kapitali i shoqerise prej 100,000 leke eshte kapitali i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

### Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Administratori Z.Endri Haxhiraj.

## 2. Zbatimi i rregullave te mbajtjes se kontabilitetit

Kontabiliteti eshte organizuar dhe mbajtur ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin". Veprimet jane regjistruar ne menyre kronologjike dhe te komjuterizuar. Çdo veprim eshte mbeshtetur ne dokumenta justifikuese. Veprimet jane ngurtesuar me 31 dhjetor 2019.

## 3.Politikat Kryesore Kontabel

Politikat kontabel te Shoqerise "Grifin Albania" sh.p.k reflektojne praktikat e ketij aktiviteti

- Aktivet e qendrushme te trupezuara paraqiten ne bilanc me koston historike minus amortizimin e akumuluar te llogaritur per kohen e shfrytezimit te tyre.
- Amortizimi eshte llogaritur ne dhe ne baze grupimi per Aktivet e qendrushme sipas normave te Ligjit Nr.8438 dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat"
- Kontabiliteti mbahet ne menyre te komjuterizuar
- Kontabiliteti mbahet ne baze te te drejtave te konstatuara.
- Shpenzimet kontabilizohen ne baze te dokumentit justifikues te shpenzimeve.
- Te ardhurat jane kontabilizuar ne baze te faturave te shitjes.

SHËRBIM EKOLOGJIK DHE KONSU
GRIFIN
ALBANIA SHPK
NIPT L61321012S
INTEGRATED PEST MANAGEMENT

BeeWise Shpk
L82320048F / +355-67-2339473
Rr. Astrit Losha, P.300/142, K1N15, Unaza e Re,Tiranë
www.beewise.net bee@beewise.net

- Llogarite ne monedhe te huaj konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise me 31.12.2019.

## 4. Aktive Qarkulluese

***4a.Likuiditete dhe vlera arke te tjera*** perfaqeson gjendjen ne banke dhe ne arke me 31.12.2020. Shoqeria ka llogari likuiduese ne, Banken Kombetare Tregtare dhe Raiffeisen Bank ne monedhat Lek.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Para ne dore | 64.153 | 1.208.350 |
| Para ne Banka | 4.170.268 | 118.518 |
| **Totali** | **4.234.421** | **1.326.868** |

Likuiditetet jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarise bankare ne daten e fundit te 31 Dhjetorit 2020, e cila eshte e njejte me ekstratin e fundit te bankes per kete periudhe si dhe llogarite ne valute jane konvertuar me kursin e Bankes Shqiperise per kete date.

**5.Kerkesa per arketim mbi debitoret** ne vleren 542.650 leke qe perfaqeson detyrime per t'u arketuar pas dates 31.12.2020.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Kliente | 542.650 | 885.690 |
| Te tjera kerkesa | | 17.728 |
| **Totali** | **542.650** | **903.418** |

***6. Shoqeria ka mallra per rishitje ne vleren 960.628 lek ne date 31.12.2020***

## 7. Aktive te qendrueshme

*Te trupezuara* Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh materiale 1,228,107 leke e cila perbehet si me poshte

Makineri dhe Pajisje 355.022 Lek
Mjete Transporti 776.212 Lek
Pajisje Kompjuterike 96.873 Lek

*Amortizimi*

Amortizimi i Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te ligjit 8438 date 28.12.1998,"Per Tatimin mbi te ardhurat". Amortizimi eshte ne vleren 289.664 leke.

SHËRBIM EKOLOGJIK DHE KONSULENCË GRIFIN ALBANIA SHPK NIPT. L61321012S INTEGRATED PEST MANAGEMENT

BeeWise Shpk
L82320048F / +355-67-2339473
Rr. Astrit Losha, P:300/142, K1N15, Unaza e Re, Tiranë
www.beewise.net bee@beewise.net

**8. Detyrime Afatshkurtra** ne vlere 1.102.686 leke perbehen si me poshte:

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Furnitore | 36.966 | 21,070 |
| Personeli | | |
| Detyrime tatimore | 539.092 | 140.250 |
| Detyrime ndaj Raiffeisen Bank | 723 | |
| Llogari ortaku | 525.905 | 2.625.905 |
| **Totali** | **1.102.686** | **2.787.225** |

Detyrimet paraqiten me vleren e tyre per tu paguar me 31.12.2020. Llogarite ne valute jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2020.

**9. Detyrimet fiskale:**
Llogarite e detyrimeve fiskale paraqiten me shumen per tu paguar Zyres se Tatimeve Tirane per llogarite Sigurime Shoqerore, TAP, tatim fitimi dhe Tatim ne Burim.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Sigurime shoqerore | 21.762 | 29.016 |
| Tatim ne burim | 1.050 | 1.050 |
| Tatim Fitimi | 236.474 | |
| Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin | 84.520 | |
| TVSH | 195.286 | 110.184 |
| **Totali** | **539.092** | **140.250** |

Detyrimet fiskale jane llogaritur drejt dhe sakte konform legjislacionit perkates.

**10. Detyrime Afatgjata** Shoqeria Grifin Albania shpk nuk ka detyrime afatgjata

**11. Kapitalet e veta** me ndryshimet perkatese paraqiten ne tabelen me poshte:

| | *Viti 2020* | *Viti 2019* |
|---|---|---|
| Kapitali | 100.000 | 100.000 |
| Fitime te pa shperndara | 1.399.796 | 190.933 |
| Fit/humbja e vitit | 4.363.324 | 1.208.863 |
| **Totali** | **5.863.120** | **1.499.796** |

**12. Shitje e sherbime** detajohet ne tabelen vijuese dhe perbehet nga te ardhurat nga shitja e sherbimeve te D.D.D dhe materialeve ndihmese.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Shitje mallra & Sherbime | 16.516.636 | 7.513.622 |

SHËRBIM EKOLOGJIK DHE KONSULENCË
GRIFIN ALBANIA SHPK
NIPT. L61321012S
INTEGRATED PEST MANAGEMENT

BeeWise Shpk
L82320048R / +355-67-2339473
Rr. Astrit Losha, P.300/142, K1N15, Unaza e Re, Tiranë
www.beewise.net bee@beewise.net

| | | |
|---|---|---|
| **Totali** | **16.516.636** | **7.513.622** |

## 13.Shpenzime per materiale.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Materiale te para, mallra dhe sherbime | 6.442.740 | 3.100.306 |
| **Totali** | **6.442.740** | **3.100.306** |

## 14.Shpenzime te personelit.

Ne kete ze perfshihen shpenzime si me poshte.

| | *31 Dhjetor 2020* | *31 Dhjetor 2019* |
|---|---|---|
| Paga dhe sigurime shoqerore | 1.432.795 | 1.417.070 |
| **Totali** | **1.432.795** | **1.417.070** |

## 15.Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit.

| | *31 Dhjetor 2020* |
|---|---|
| Sherbime bankare | 37.328 |
| Qera | 84.000 |
| Shpenzime karburant energji uje e te tjera | 3.440.643 |
| Shpenzime Amortizimi | 289.664 |
| Shpzenzime te panjohura | 9.020 |
| **Totali** | **3.860.655** |

## 16.Shpenzime Financiare.

Shpenzimet financiare jane ne vleren 37.328 lek per vitin 2020.

**17.Fitimi Neto** Fitimi neto eshte llogaritur si me poshte.

| | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Fitim Bruto | 4.780.446 | 1.274.992 |
| Shpenzime te pa njohura | 9.020 | 47.588 |
| HumbjeFiskaleMbartur | 0 | 0 |
| Baza llogaritjes Tatimit | 4.789.466 | 1.322.580 |
| % e tatim Fitimit | 5 %dhe 15 % | 0 |
| **Tatim Fitimi** | **(417.122)** | **(66.129)** |
| **Fitimi NETO** | **4.363.324** | **1.208.863** |

*Administratori*

*Enari Haxhiraj*

GRIFIN ALBANIA SHPK NIPT. L61321012S INTEGRATED PEST MANAGEMENT

BeeWise Shpk
L82320048R / +355-67-2339473
Rr. Astrit Losha, P.300/142, K1N15, Unaza e Re, Tiranë
www.beewise.net bee@beewise.net